

# Buletini 16

Janar – Qershor 2020



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



## Prezantimi i Buletinit – Aktivitetet rregulative në kohë pandemie



Arsim Janova  
u.d Kryesues i Bordit të ZRRE

Përgjatë periudhës gjashtë mujore, janar – qershor 2020, Rregullatori i Energjisë është përpjekur që aktivitetet t'i zhvilloi në përputhje me obligimet ligjore dhe me planin e punës së këtij vit, përkundër sfidave dhe vështirësive që janë shkaktuar si pasojë e situatës pandemike të shkaktuar nga virusi COVID 19.

Një pjesë të kohës personeli i ZRRE është detyruar të punojë nga shtëpia, përderisa në zyrë është organizuar puna me personelin esencial të organizuar në rotacion për të mbuluar prezencën e të gjitha departamenteve.

Bordi i ZRRE ka mbajtur katër seanca gjatë kësaj periudhe ku ka shqyrtuar dhe marrë vendime për 44 çështje që kanë të

Rregullatori ka zhvilluar procesin e shqyrtimit tarifor në përputhje me rregullat për vendosjen e çmimeve dhe Bordi ka marrë vendimet fillimisht për të Hyrat Maksimale të Lejuara (HML) dhe pastaj edhe për tarifën e sistemeve të Transmetimit dhe Shpërndarjes dhe ato të Shërbimit Universal të furnizimit me energji elektrike.

Monitorimi i operimit të ndërmarrjeve dhe ofrimit të shërbimeve të licencuara është intensifikuar në veçanti gjatë kohës së pandemisë, me qëllim që të sigurohet mbarëvajtje e funksionimit të sektorit në përgjithësi. ZRRE ka kërkuar nga operatorët të sigurohet planifikim i duhur dhe informim i saktë për riorganizimet që operatorët kanë kryer në menaxhimin e operimeve gjatë pandemisë.

Gjatë kësaj periudhe ZRRE ka zhvilluar tri konsultime publike, të cilat për shkak të rrethanave janë vënë në dispozicion të publikut vetëm përmes platformave online. Përveç procesit të shqyrtimit tarifor, ZRRE ka marrë vendimet, pas diskutimeve publike, edhe për bilancet e energjisë elektrike dhe Rregullën për integritet dhe transparencë të tregut.

Ndër aktivitetet të tjera me rëndësi për publikun, ZRRE po ashtu ka punuar në ridizajnimin e faqes së internetit dhe ka përgatitur dhe dorëzuar Raportin vjetor në Kuvendin e Kosovës. Raporti është aprovuar deri më tani nga Komisioni për Ekonomi dhe mbetet të shqyrtohet edhe në seancë plenare.

### PËRMBAJTJA

- ORGANIZIMI I RREGULLATORIT, DHE MASAT E NDËRMARRA NGA TË LICENCUARIT NË KOHË PANDEMIE
- PROCESI I SHQYRTIMIT TARIFOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE
- PËRKUJDESI NDAJ KONSUMATORËVE NË KOHË PANDEMIE
- APROVIMI I REMIT
- PAROVIMI I RAPORTIT VJETOR TE ZRRE NGA KOMISIONI PARLAMENTAR
- BASHKËPUNIMI DHE PËRFAQËSIMI NDËRKOMBËTAR
- FAQJA E RE E INTERNETIT TË ZRRE
- VENDIMIET E BORDIT

## Organizimi i veprimtarisë së Rregullatorit, dhe masat e ndërmarra nga të licencuarit në kohë pandemie

Me qëllim që të sigurohet mbarëvajtje e funksionimit të sektorit në përgjithësi, ZRRE ka intensifikuar monitorimin e operimit të ndërmarrjeve dhe ofrimit të shërbimeve të licencuara, në veçanti gjatë kohës së pandemisë. Rregullatori ka kërkuar nga operatorët të sigurohet planifikim i duhur dhe informim i saktë për riorganizimet që kanë kryer në menaxhimin e operimeve gjatë pandemisë.

Me marrjen e masave nga Qeveria, pas shfaqjes së rasteve të para të të infektuarve me virusin COVID 19, ZRRE ka organizuar punët me numër minimal të personelit të cilët duhet të ishin në zyrë me orar rotativ, përderisa pjesa tjetër e personelit kanë punuar nga shtëpia.


Takimet e brendshme janë organizuar me pjesëmarrjen e vetëm të personelit të domosdoshëm duke siguruar distancën në përputhje me udhëzimet e dhëna nga institucionet përkatëse të shëndetësisë. Tri nga pesë seancat e Bordit janë mbajtur pa prezencën e publikut dhe janë mënjanuar pothuajse të gjitha takimet që krijojnë grumbullim të madh të pjesëmarrësve (diskutime publike, debat, seancë përgatitore etj.) ZRRE ka informuar publikun dhe mediat në vazhdimësi përmes faqes së internetit, postës elektronike dhe mediave sociale.

Edhe pse është kërkuar nga konsumatorët që ankesat e tyre t'i dërgojnë përmes postës elektronike, në ZRRE gjithmonë ka qenë personeli i angazhuar për përkujdesje të konsumatorëve, me qëllim që të sigurohet se shqetësimet e tyre po trajtohen me prioritet gjatë tërë kohës.

Sektori i energjisë elektrike gjatë periudhës janar – qershor 2020 ka funksionuar normalisht me të gjitha kapacitetet e tij. Gjatë periudhës janar – qershor 2020, ku përfshihet edhe periudha e pandemisë me COVID – 19, e posaçërisht në periudhën kur vendi ynë ka qenë nën masat e kufizimit të lëvizjes, furnizimi me energji elektrike ka qenë i qëndrueshëm dhe stabil. Vlen të theksohet se gjatë periudhës së pandemisë nga të të gjithë të licencuarit, duke filluar nga Korporata Energjetike e Kosovës, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, dhe Furnizuesi KESCO janë ndërmarrë të gjitha masat për sigurinë e punonjësve të tyre, në përputhje me rekomandimet e institucioneve shëndetësore të vendit.

Disa nga masat kryesore që janë ndërmarr nga të licencuarit gjatë periudhës së pandemisë kanë qenë:

- shtyrja e mirëmbajtjeve të planifikuara të njësive gjeneruese;
- mos shkyçja e konsumatorëve për shkak të faturës së pa paguar të energjisë elektrike;
- faturimi i konsumatorëve ka vazhduar në përputhje me procedurën e leximit të pikave matëse, vetëm në rastet kur nuk ka pasur mundësi leximi atëherë është bërë faturim me vlerësim dhe edhe kjo në përputhje me procedurën e leximit të pikave matëse;
- qendra e thirrjeve në KESCO për konsumatorë ka punuar 24 orë në 7 ditë të javës;
- zyrat e furnizuesit KESCO ku bëhen pagesat kanë qenë të hapura;
- konsumatorët, kanë pasur në dispozicion edhe mundësitë tjera për pagesën e faturave të energjisë elektrike dhe atë përmes e - banking, aplikacioneve tjera mobile, postës etj;
- ndërprerjet e planifikuara janë shtyrë dhe janë bërë vetëm mirëmbajtjet e domosdoshme të cilat janë bërë në funksion të mbajtjes së gjendjes stabile të furnizimit me energji elektrike.



## Procesi i shqyrtimit të tarifave të energjisë elektrike

Në seancën e dytë, të mbajtur me 6 prill 2020, Bordi i ZRRE ka miratuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të operatorëve të Transmetimit/Tregut (KOSTT), Shpërndarjes (KEDS) dhe Furnizimit Universal (KESCO) me energji elektrike. Vlera e përgjithshme e miratuar e HLM për periudhën rregullative prill 2020 - mars 2021 është vendosur të jetë 268.9 milion euro. Vendimit për MAR-et e operatorëve i ka paraprirë një proces i gjatë konsultativ i cili ka filluar në fund të vitit 2019 me dorëzimin e aplikacioneve/kërkesave për përshtatjet vjetore të të hyrave të lejuara maksimale, nga operatorët e licencuar për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit publik me energji elektrike.

Bazuar në vlerën aprovuar të HLM-ve të operatorëve me çmime të rregulluara, me 8 prill 2020 KESCO ka dorëzuar në ZRRE kërkesën për tarifën për konsumatorët fundor, të cilët furnizohen nga Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU-KESCO). Bordi i ZRRE në seancën e tretë të tij, të mbajtur me 17 prill 2020, ka vendosur që tarifën e furnizimit nga shërbimi universal të mbesin në fuqi si në strukturën tarifore paraprake. Përderisa tarifën për shfrytëzimin e rrjetit të Transmetimit dhe rrjetit të Shpërndarjes të ndryshojnë nga ato të viteve të kaluara, në përputhje me të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR), por këto ndryshime nuk kanë reflektuar në tarifën përfundimtare të konsumatorëve të rregulluar për periudhën rregullative 1 prill 2020 - 31 mars 2021. Të gjitha materialet e ndërlidhura me proceset e shqyrtimeve tarifore janë të publikuara në faqen elektronike zyrtare të ZRRE [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org).

<b>Struktura Tarifore prill 2020 – mars 2021</b>					
Grupi Tarifor	Niveli I tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Aprovuar 2018
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		11.19
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		5.85
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	4.92
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.16
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.62
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.04
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.73
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.69
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.57
		Fuqia e angazhuar	€/kW		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.69
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.96
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.67
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.97
		Fuqia e angazhuar	€/kWh	Tarifë e vetme	8.83
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	10.71
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5.30
		5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj
Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh			Tarifë e Lartë	6.75
	€/kWh			Tarifë e Ulët	2.89
6	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh		5.32
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh		6.75
8	Ndriçimi Publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.21
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	9.24

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor 31 mars  
 Tarifa e ulët aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator  
 Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me  $\cos(\Phi) < 0.95$

## Përkujdesi ndaj konsumatorëve

Duke pasur një ndër prioritet e tij kryesore shërbimet e kënaqshme për konsumatorët, Rregullatori ka intensifikuar aktivitetet e tij në këtë drejtim me qëllim që të sigurohet se konsumatorët po marrin shërbimet e nevojshme me energji përkundër rrethanave të pandemisë të shkaktuara nga Virusi COVID 19.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) gjatë periudhës janar - qershor 2020 ka regjistruar 33 ankesa të konsumatorëve të cilët kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre kundër përgjigjeve të lëshuara nga ana e Furnizuesit, si dhe ka kthyer në rishqyrtim 85 ankesa tek Furnizuesi dhe Operatori i sistemit të shpërndarjes. ZRRE përveç ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe të zgjidhura, ka ofruar mbështetje edhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve, konsultimeve verbale, postës elektronike, si dhe përmes telefonit për të gjithë konsumatorët e energjisë.

Gjatë periudhës janar - qershor 2020, ZRRE ka zgjidhur 100 ankesa të konsumatorëve, ku përfshihen edhe ankesat të cilat janë kthyer për rishqyrtim tek furnizuesi dhe operatori i sistemit të shpërndarjes. Të gjitha ankesat e shqyrtuara nga ana e operatorëve, e të cilat janë proceduar te Rregullatori, janë rishqyrtuar edhe njëherë nga Rregullatori me qëllim të vërtetimit të zgjidhjes së plotë të ankesave sipas kërkesave të konsumatorëve, si dhe janë njoftuar konsumatorët. Në të gjitha rastet e rishqyrtuara konsumatorët janë pajtuar me zgjidhjet e ofruara.

Gjatë periudhës janar - qershor 2020, ZRRE ka pranuar edhe 6 ankesa të konsumatorëve përmes postës të cilat edhe përkundër faktit që është dashur t'iu drejtohen të licencuarve apo gjykatave, insistimi i tyre ka qenë që t'i drejtohen Rregullatorit për zgjidhjen e ankesave të tyre. Natyra e këtyre ankesave kryesisht ka qenë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, si dhe kompensim dëmi. ZRRE në kuadër të kompetencave të veta i'u është përgjigjur me shkrim konsumatorëve duke i udhëzuar të njëjtit për procedurat e mëtejme lidhur me ankesat e tyre



*ZRRE përveç ankesave të regjistruara gjatë periudhës janar - qershor 2020 ka zhvilluar edhe 777 takime dhe 362 biseda telefonike me palët përfshirë edhe komunikimin elektronik, të cilët i janë drejtuar zyrës për çështje të ndryshme kontraktuale mes konsumatorit dhe ndërmarrjes së energjisë. Gjatë komunikimit me konsumatorët, ZRRE i ka njoftuar dhe udhëzuar ata për rregullat, procedurat si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me furnizimin me energji.*

## Vendimet e Bordit të Rregullatorit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve

Në bazë të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, konsumatorët dhe të licencuarit kanë të drejtë të apelojnë vendimin e DMK si instancë e shkallës së parë në Bordin e Rregullatorit si instancë e shkallës së dytë.

Gjatë periudhës janar - qershor 2020 konsumatorët kanë parashtruar 4 ankesa në Bordin e Rregullatorit kundër vendimeve të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve. Furnizuesi KESCO gjatë periudhës janar - qershor 2020 ka parashtruar 8 ankesa në Bordin e Rregullatorit kundër vendimeve të DMK.

Bordi i Rregullatorit gjatë kësaj periudhe ka shqyrtuar 3 rekomandime të nxjerra nga DMK për ankesat e konsumatorëve komercial dhe industrial, me ç' rast Bordi i ka aprovuar të gjitha këto rekomandime.

## Aprovimi i rregullës REMIT

Me 23 qershor 2020, në mbledhjen e tij të katërt, Bordi i Rregullatorit ka aprovuar Rregullën për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT). Kjo rregull, e cila do të zbatohet nga Rregullatori i energjisë, përcakton kriteret që ndalojnë praktikën abuzive të cilat ndikojnë në tregjet e energjisë me shumicë, dhe parashikon po ashtu monitorimin e tregjeve të energjisë me shumicë në vend. Aprovimi i kësaj rregulle dëshmon rëndësinë që Rregullatori i kushton tregut konkurrues, dhe nevojës për të siguruar integritetin e këtij tregu, bazuar në Acquit e Bashkimit Evropian, sidomos duke ditur se Rregullatori i Kosovës është i pari nga palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë që po aprovon këtë rregull.

REMIT është një rregullore e Bashkimit Evropian (BE) për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë (Nr. 1227/2011). Kjo rregullore ka hyrë në fuqi që nga 28 dhjetori 2011 dhe Kosova si palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë ka për obligim ta transpozojë atë siç ka për obligim që të zbatoj edhe legjislacionin tjetër për energji të BE-së.

REMIT siguron një kornizë të qëndrueshme rregullative në të gjithë BE-në, specifike për tregjet me shumicë të energjisë.

REMIT krijon një kornizë rregulluese shumë të rëndësishme për identifikimin dhe penalizimin e abuzimit të tregut në Kosovë dhe në pjesën tjetër të Evropës. Po ashtu ndihmon konsumatorët, industrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të krijojnë besim se çmimet me shumicë të energjisë janë të hapura, të drejta dhe konkurruese- themel i një tregu energjetik që funksionon në mënyrë efektive.





## Miratimi i raportit vjetor të ZRRE nga Komisioni Parlamentar

Pas dorëzimit në Kuvendin e Kosovës të Raportit vjetor të ZRRE, Bordi dhe menaxhmenti i ZRRE, me 26 maj 2020, kanë paraqitur Raportin para Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike. Me ç' rast kanë raportuar për aktivitetet që ndërlidhen me fushëveprimin e Rregullatorit, si dhe funksionimin e sektorit të energjisë, duke analizuar të dhënat e të licencuarve, përfshirë edhe zhvillimin e tregut të energjisë në Kosovë. Në takimin pasues të Komisionit, të mbajtur me 28 maj 2020, anëtarët Komisionit kanë aprovuar Raportin i cili pritet të shqyrtohet edhe në seancën plenare.

Të gjitha raportet vjetore të ZRRE janë të publikuara në vegzën: <https://www.ero-ks.org/zrre/sq/publikimet/raportet-vjetore>.



*Raportimi i Bordit dhe menaxhmentit të ZRRE para Komisionit Parlamentar*

## Aktivitetet ndërkombëtare dhe bashkëpunimi rajonal

Rregullatori i përfaqësuar nga personeli i tij ka ndjekur të gjitha aktivitetet ndërkombëtare që janë organizuar online, sidomos ngjarjet e organizuara nga Komuniteti i Energjisë, Asociacionet e Rregullatorëve (ERRA, NARUC, CEER) si dhe aktivitet të tjera që ZRRE është e përfshirë.

### **Pjesëmarrja në Komunitetin e Energjisë**

Përfaqësuesit e ZRRE, me 23 janar 2020, kanë marrë pjesë në takimin e rregullt të grupit punues për konsumatorë dhe tregjet me pakicë të ECRB (Energy Community Regulatory Board). Gjatë takimit përveç diskutimeve lidhur me aktivitetet e grupit punues, pjesëmarrësit e ZRRE kanë prezantuar për zhvillimet e fundit të sektorit të energjisë dhe të aktivitetet e Rregullatorit.

Po ashtu përfaqësuesit e ZRRE me datë 27.05.2020 kanë marrë pjesë në takimin e rregullt punues për konsumatorë dhe tregjet me pakicë të ECRB (ECRB CRM). Ku gjatë takimit përveç diskutimeve lidhur me aktivitetet e grupit, përfaqësuesi i DMK-ZRRE ka mbajtur prezantim për zhvillimet e fundit të sektorit të energjisë dhe të aktiviteteve të Rregullatorit nga takimi i fundit.

Në grupin punues për konsumatorë dhe tregjet me pakicë të ECRB (ECRB CRM) përfaqësuesi i ZRRE është edhe udhëheqës i njëjës nga detyrat “Task Forcës” lidhur me temën “Gjenerata e re e konsumatorëve dhe komunikimi digjital”. Duhet theksuar se qëllimi i këtij Raporti është mbledhja e informatave mbi nivelin e dixhitalizimit të shërbimeve, dhe kanalet digjitale të komunikimeve të siguruara nga ndërmarrjet e energjisë dhe rregullatorët për konsumatorët në Palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.

### Bashkëpunimi me NARUC

Përfaqësuesit e ZRRE po ashtu janë të përfshirë në disa nga programet që NARUC organizon me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të tregjeve të lira në rajon. Si dhe ka marrë pjesë rregullisht në ueb-seminaret e organizuara që kanë pasur për tema:

- Marrjen në konsideratë të tarifave të rregulluara për shkak të Pandemisë
- Përmirësimin e planifikimit të investimeve përmes zbatimit të standardeve të cilësisë së shërbimeve
- Rolin rregullator në mbështetjen e investimeve për sigurinë kibernetike
- Planet e tranzicionit dhe rikuperimin e kostove pas Pandemisë COVID-19



*Përfaqësuesi i ZRRE, Z. Ymer Rudari, merr pjesë në rolin e panelistit në ueb-seminarin e organizuar nga NARUC për Sigurinë Kibernetike*

### Pjesëmarrja në aktivitetet e ERRA

Duke qenë anëtare e asociar e ERRA-s, ZRRE ka anëtarët e saj të rregullt të emëruar në grupet punuese dhe grupin e kryesuesve, të cilët kanë mbajtur takimet e tyre edhe gjatë kësaj periudhe, por përmes internetit.

Disa nga ueb-seminaret janë organizuar në bashkëpunim me NARUC dhe CEER, sidomos ato që kanë trajtuar problemet e krijuara në sektorët e energjisë nga pandemia e shkaktuar nga COVID 19.

## ZRRE më afër konsumatorëve përmes faqes së re të dizajnuar të internetit

Në vazhden e përpjekjeve për një transparencë dhe përfshirje më të madhe të publikut në proceset rregullative, më 5 korrik 2020, ZRRE se ka lansuar faqen e ri-dizajnuar të internetit: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)

Qëllimi i ri-dizajnit ka qenë, përveç transparencës më të madhe dhe përshtatjes me pajisjet mobile, edhe ofrimi i informatave në një formë më të lehtë për konsumatorët dhe palët e tjera të interesuara për aktivitetet rregullative të sektorit të energjisë. Gjithashtu faqja e re e internetit plasoi informatat e nevojshme për operatorët e interesuar për licencimin e aktiviteteve të tyre si dhe për investitorët që janë të interesuar të investojnë në sektorin e energjisë. Për më shumë informata ZRRE ju fton të vizitoni faqen [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)

The screenshot displays the homepage of the Energy Regulatory Office (Zyra e Rregullatorit për Energji) website. At the top, there is a navigation bar with links for 'BALLINA', 'PËR NE', 'LEGJISLACIONI', 'LAJMET', 'KONSULTIMET PUBLIKE', 'PUBLIKIMET', and 'KONTAKTI'. The main content area features a central mission statement box, three primary service buttons for 'KONSUMATORËT SHITËPIAK', 'KONSUMATORËT KOMERCIAL', and 'PIJESËMARRËSIT NË TREG', and three category buttons for 'Energjia Elektrike', 'Energjia Termike', and 'Gazi'. Below these are five menu items: 'REMIT', 'PCT', 'SHQYRTIME TARIFORE', 'BRE', and 'MONITORIMI'. The section 'AKTIVITETET AKTUALE TË ZRRE-SË' lists three recent events with dates and brief descriptions.

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERJJI**  
REGULATORI I PËR ENERJJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE

Misioni i ZRRE-së është që të krijojë një treg të qëndrueshëm të energjisë në Kosovë të bazuar në parimet e transparencës dhe konkurrencës së lirë, e cila anton vlerat si për konsumatorët ashtu dhe për ndërmarrjet.

Më Shumë Për ZRRE ...

KONSUMATORËT SHITËPIAK  
KONSUMATORËT KOMERCIAL  
PIJESËMARRËSIT NË TREG

Energjia Elektrike  
Energjia Termike  
Gazi

REMIT  
PCT  
SHQYRTIME TARIFORE  
BRE  
MONITORIMI

**AKTIVITETET AKTUALE TË ZRRE-SË**

Aktivitetet / lajmet e Zyres së Rregullatorit të Energjisë:

**Është mbajtur Seanca e V e Bordit të ZRRE**  
5 July 2020  
Bordi i Rregullatorit për Energji, ka mbajtur sot seancën e tij të pestë (V) më radhë për këtë vit.

**Është Mbajtur Seanca e IV e Bordit të ZRRE për këtë vit**  
23 June 2020  
Sot më 23 qershor 2020, Bordi i Rregullatorit për Energji, ka mbajtur Seancën e tij të katërt (IV) për këtë vit.

**Seanca e IV e Bordit të ZRRE për vitin 2020**  
19 June 2020  
Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) njofton të gjitha palët se seanca e ardhshme e Bordit të ZRRE, e katërta (IV) më radhë për këtë vit, është parapardë t



**Vendimet e Bordit të ZRRE (janar – qershor 2020)**

- V\_1266\_2020** – Vendimi për kërkesën e KOSTT SH.A. për Derogimet e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut dhe Licencës së OST
- V\_1265\_2020** - Vendimi për kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për ndryshim të koeficienteve të humbjeve të OSSH.
- V\_1264\_2020** - Vendimi për kërkesën e KOSTT SH.A. për amendamentimin e dokumentit “Procedura e Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve”
- V\_1263\_2020** – Vendimi për miratimin e Bilancit të Rishikuar Vjetor të Energjisë Elektrike 2020
- V\_1262\_2020** - Vendimi për amendamentimin e Rregullës dhe Metodologjisë për përgatitjen e Bilanceve të Energjisë Elektrike dhe Termike
- V\_1261\_2020** - Vendimi për miratimin e Rregullës për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me shumicë
- V\_1260\_2020** - Vendimi për refuzimin e ankesës së KESCO ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A. Th.
- V\_1259\_2020** – Vendimi për miratimin e pjesërishëm të ankesës së KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Harxhimi i përbashkët – I.M.
- V\_1258\_2020** - Vendimi për refuzimin e pjesërishëm të ankesës së konsumatorit M.D.
- V\_1257\_2020** - Vendimi për refuzimin e ankesës së konsumatorit S.R.
- V\_1256\_2020** – Vendimi për aprovimin e emërimit të Zyrtarit të Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes i bërë nga Bordi Ekzekutiv i OSSH (KEDS SH.A).
- V\_1255\_2020** – Vendimi për aprovimin e kërkesës së aplikuesit “BALLKAN PETROL” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Komunën e Ferizajt.
- V\_1254\_2020** - Vendimi për aprovimin e kërkesës së aplikuesit “Komuna e Obiliqit”, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Komunën e Obiliqit
- V\_1253\_2020** - Vendimi për aprovimin e kërkesës së aplikuesit personit fizik Hashim Jonuzaj për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Komunën e Prizrenit.

**V\_1252\_2020** - Vendimi për aprovimin e kërkesës së aplikuesit "GELI" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Komunën e Gjakovës.

**V\_1251\_2020** – Vendimi për lëshimin e licencës për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes "Balkan Energy" LLC, me numër licence ZRRE/Li\_ZRRE/Li\_67/20 për periudhën 23 qershor 2020 - 22 qershor 2025.

**V\_1250\_2020** - Vendimi për aprovimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe tregut (KOSTT), për periudhën 1 prill 2020 – 31 mars 2021

**V\_1249\_2020** - Vendimi për aprovimin e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e Shërbimit Universal të Furnizimit, që do të zbatohen nga i licencuari KESCO SH.A., duke filluar nga data 1 prill 2020 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor

**V\_1248\_2020** - Vendimi për aprovimin e tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS) për periudhën 1 prill 2020 - 31 mars 2021.

**V\_1247\_2020** – Vendimi për refuzimin e ankesës së konsumatorit Y. Sh.

**V\_1246\_2020** - Vendimi për refuzimin e ankesës së konsumatorit R. Ll.

**V\_1245\_2020** - Vendimi për refuzimin e ankesës së konsumatorit Sh.K.

**V\_1244\_2020** - Vendimi për aprovimin e kërkesës së aplikuesit "Samiri-I-H&A" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin e ndërtuar sipas Aktvendimit nr. 12. Nr. 40 të datës 24.02.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në Komunën e Rahovecit.

**V\_1243\_2020** - Vendimi për aprovimin e kërkesës së shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K., për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V\_882\_2017 të datës 09 shkurt 2017 i Modifikuar me Vendimin V\_1055\_2018 i të datës 15 tetor 2018 dhe Vendimin V\_1115\_2019 të datës 28 shkurt 2019 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Restelica 3, në Lumin Restelica ZK Krushevë dhe Gllloboqicë

**V\_1242\_2020** - Vendimi për aprovimin e kërkesës së shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K., dhe SHTYHET afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V\_881\_2017 të datës 09 shkurt 2017 i Modifikuar me Vendimin V\_1054\_2018 i të datës 15 tetor 2018 dhe Vendimin V\_1114\_2019 të datës 28 shkurt 2019 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Brodi 1, në Lumin Brod ZK Brod

**V\_1241\_2020** - Vendimi për aprovimin e kërkesës së shoqërisë NPN "Renelual Tahiri" SH.P.K., dhe SHTYHET afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V\_923\_2018 të datës 29 mars 2018 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Dragash, ZK Radesh, Plavë dhe Rapçë

**V\_1240\_2020** - Vendimi për aprovimin e të hyrave maksimale të lejuara për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU/KESCO)

**V\_1239\_2020** – Vendimi për aprovimin e të hyrave të lejuara maksimale që do të mbulohen nga Operatori i Licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) KEDS SH.A

**V\_1238\_2020** – Vendimi për aprovimin e të hyrave të lejuara maksimale që do të mbulohen nga Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut-KOSTT SH.A.

**V\_1237\_2020** – Vendimi për refuzimin e ankesës së KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin E. S. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR - 90073446 si e pa bazuar.

**V\_1236\_2020** - Vendimi për refuzimin e ankesës e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin N. H. nga fshati Raskovë, Kastriot, me shifër të konsumatorit DPR - 56321 si e pa bazuar.

**V\_1235\_2020** - Vendimi për refuzimin e ankesës së KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin M. R. nga Komuna e Shtinmës, me shifër të konsumatorit DFE - 9044417 si e pa bazuar.

**V\_1234\_2020** - Vendimi për refuzimin e ankesës së KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin L. B. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR - 90111950 si e pa bazuar.

**V\_1233\_2020** - Vendimi për refuzimin e ankesës së KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A. M. nga Mitrovica, me shifër të konsumatorit DMI – 9052315 si e pa bazuar.

**V\_1232\_2020** - Vendimi për refuzimin e ankesës së KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin R. J. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR - 90111259 si e pa bazuar.

**V\_1231\_2020** - Vendimi për refuzimin e ankesës së konsumatorit I. K. nga Komuna e Fushë Kosovës si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

**V\_1230\_2020** - Vendimi për refuzimin e ankesës së konsumatorit konsumatorit E. F. K. G. nga Komuna e Ferizajt, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

**V\_1229\_2020** – Vendimi për kërkesën e shoqërisë “Hydro Line” SH.P.K. për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC “Albaniku 4” në lokacionin ZK Selac dhe Vidishiq, komuna e Mitrovicës

**V\_1228\_2020** - Vendimi për kërkesën e shoqërisë “Hydro Line” SH.P.K. për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC “Albaniku 1” në lokacionin ZK Vllahi, komuna e Mitrovicës

**V\_1227\_2020** – Vendimi për aprovimin e kërkesës së shoqërisë “DINO ENERGY” SH.P.K., për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Preliminar për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Lepenci 2”, ZK Kaçanik, në Komunën e Kaçanikut

**V\_1226\_2020** - Vendimi për aprovimin e kërkesës së shoqërisë “Matkos Group” SH.P.K. për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final për ndërtimin e Hidrocentralit HC “Shtërpce” ZK Shtërpce, Komuna e Shtërpcës

**V\_1225\_2020** - Vendimi për aprovimin e kërkesës së shoqërisë “Matkos Group” SH.P.K. për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final për ndërtimin e Hidrocentralit “Sharri” ZK Shtërpce, Komuna e Shtërpcës

**V\_1224\_2020** - Vendimi për aprovimin e kërkesës së shoqërisë “2 Korriku” SH.P.K., për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Soponica”, ZK Doganaj, Komuna e Kaçanikut

**V\_1223\_2020** – Vendimi për aprovimin e Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS SH.A.)

**Adresa:** Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620,  
E-mail: [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org), web:  
[www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)

Për konsumatorë:  
Tel: +381 (38) 247 615 lok. 116  
Email: [ankesa.dmk@ero-ks.org](mailto:ankesa.dmk@ero-ks.org)

Për çështje ligjore, licencim, BRE/autorizim:  
Tel: +381 (38) 247 615 lok. 114, 117, 118  
Email: [legal-licensing@ero-ks.org](mailto:legal-licensing@ero-ks.org)